

VENDIM
Nr.883, datë 27.12.2006

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.88, DATË 1.3.1993 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E ZONAVE, QË KANË PËRPARËSI ZHVILLIMIN E TURIZMIT”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2 të ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave, që kanë përparësi turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit nr.88, datë 1.3.1993 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në shkronjën “A”, pas fjalëve “Territoret nga Pojani në plazhin e Semanit, në rrethin e Fierit” të shtohen “...përfshijë parcelat:

a) Parcela 1, 150 ha, bregu i detit Adriatik: në veri të kanalit të Hoxharës, me koordinata: X 14 726 — 15 176 dhe Y 63049 — 63 716 dhe në jug të kanalit të Hoxharës, me koordinata: X 13 781 — 14581 dhe Y 63 046 — 64 544.

b) Parcela 2, 100 ha, bregu i detit Adriatik: në jug të kanalit të Povelcës, me koordinata: X 09480 — 10280 dhe Y 62 315 — 63 565.

c) Parcela 3, 60 ha, 1 km në veri të lumit Vjosë, bregu i detit Adriatik, me koordinata: X 06 747-07 572 dhe Y 60 097 — 61 233.”.

2. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha